



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:069949
 Datë: 28.01.2021
 Numri i dokumentit: 00967236

C.nr.988/20

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen kontestuese të paditësit E.B., me numër personal të letërnjoftimitnga Fshati Komuna e Ferizajit Rruga ‘’.....,nr....., të cilin në bazë të autorizimit i përfaqëson av.Leutrim Ademi ,nga Mitrovica Rr’’A Zhitia’’ pn, kundër të paditurit Universiteti i Shkencave të Aplikuara ‘’Ferizaj’’, me adresë Rr’’Rexhep Bislimi Ferizaj, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson Armend Hysa ,sekretar i përgjithshëm te e paditura ,baza juridike :kompenzimi i shpenzimeve të ushqimit, me datë 28.01.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses E.B.dhe **DETYROHET** e paditura Universiteti i Shkencave të Aplikuara ‘’Ferizaj’’ që paditëses E.B. të ia paguaj shumat siq vijon: në emër të kompenzimit të shpenzimeve të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë,për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më datën 11.03.2020 në kohëzgjatje prej 111 ditë pune ,shumën prej 222 euro,të gjitha me kamatë prej 8 % në vit duke llogaritur nga data e ushtrimit të padis me datë 16.06.2020 e deri në pagesën definitive ,kurse në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumat siq vijon:për padi 104 euro,për përfaqësim në seancë 135 euro,për taksën për padi 21 euro,të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja E.B.,ka parashtruar me padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurës Universiteti i Shkencave të Aplikuara ‘‘Ferizaj’’, me bazë juridike kompensimi i shpenzimeve të ushqimit.

Nga thënjet e paditëses në padi rezulton se i njejta padin e bazonë në faktet e theksuara:se është në mardhënje pune te e paditura si punëdhënës i fundit i tij por e paditura paditësit nuk ia ka paguar shumat që i kërkonë me kërkesëpadi edhe pse të njejtat i takojnë paditësit në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë,në fuqi nga data 18.04.2017.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses avokati Leutrim Ademi ,nga Ferizaji ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit me përmbajtje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura Universiteti i Shkencave të Aplikuara ‘‘Ferizaj’’ në përgjegjje në padi përmes të autorizuarit Armend Hysa ka deklaruar:Sindikata e Pavarur në USHAF përmes nënkryetares B.B.,me datën 28.02.2020 ka bërë kërkesë Këshillit Drejtues të USHAF për kompensimin e shujtës ushqimore për punonjësit e USHAF ,anëtarë të Sindikatës ndër ta edhe për punonjëses E.B..Këshilli Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj [USHAF]në mbledhjen e mbajtur më datën 02.03.2020 ka shqyrtuar kërkesën e Sindikatës dhe për shkak të mungesës së mjeteve financiare të distinuara në buxhetin e vitit fiskal 2020 për implementimin e kësaj kërkesë ,të njejtën e ka refuzuar.Duke marrë parasysht sipër të shënuarat i padituri e konteston padinë e paditësit dhe i propozon Gjykatës Themelore në Ferizaj që të nxjerr këtë:Aktgjykim Hudhet Poshtë padia e paditëses E.B.,kundër të paditurit Universiteti i Shkencave të Aplikuara ‘‘Ferizaj’’ [USHAF] dhe vërtetohet vendimi i Këshillit Drejtues të USHAF nr.766/20 ,të datës 02.03.2020 ,për refuzim të kërkesës për kompensimin e shujtave ushqimore.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civile juridike janë administruar si provë: kërkesa për shujtën ushqimore ,vendimi i datës 02.03.2020 ,i të paditurës kontrata e punës në emër të paditësit ,vërtetimi ,i datës 20.11.2020 ,me numër 3051 ,në emër të paditësit..

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me leximin e kontratës me numër të protokollit 3366/19 ,e datës 27.09.2017 gjykata ka vërtetuar se paditësja E.B. ka themeluar mardhënje pune te e paditura në cilësin e mësimdhënëses.

Me leximin e vërtetimit me nr të protokollit 3051 ,i datës 20.11.2020 ,i lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se paditësja në Universitetin e Shkencave të Aplikuara ‘‘Ferizaj’’ ,në periudhën kohore 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020 ka gjithsejt 111 ditë pune

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues ekzistimi i faktit se e paditura paditësit nuk ia ka paguar shumat e mjeteve monetare që paditësit i kërkonë me kërkesëpadi.

Me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë,të datës 18.04.2017 është paraparë të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës ,për ditët e pranishme në punë ,për një ditë pune është 2[dy]euro ,për të punësuarit që kanë mardhënjën e punës primare në institucionet arsimore .

Kjo gjykatë duke u nisur nga dispozitat e sipër përmendura të Kontratës Kolektive Sektoriale, si dhe gjendjes faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar si më lartë ,ka ncjerrur përfundim se është e bazuar kërkespadija e paditësve dhe nga kjo arsye edhe e ka detyruar të paditurën që paditësve t’ua paguaj shumën si në pikën I, dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe thënjet e përfaqësuesit të të paditurës i cili kërkesëpadin e kundërshton duke u bazuar edhe në mungesën e mjeteve financiare ,mirëpo gjykata konsideron se theksimi në fjalë i të paditurës nuk e liron nga obligimi për pagesën e shumave si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ,sepse kontratat e nënshkruara në mes të palëve kanë bazën ligjore në Ligjin për Mardhënjët e Detyrimeve, dispozitat përkatëse të këtij ligji që e rregullojnë materien e qështjes së kontratës,kurse konform nenit 8 të Ligjit për Mardhënjët e Detyrimeve Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të Ligjit për Mardhënjët e Detyrimeve i Kosovës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Gjyqtari

Burim Emërllahu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.

